



Pozitë e Lirë:

Ndihmëse Kuzhine

Bëhu pjesë e familjes Pasa Doner!

Vendi: PasaDoner (Albi Mall dhe Prishtina Mall)

Lloji i punës: Full-time / Part-time

PasaDoner është një vend pune ku ngrohtësia kolektive dhe mikpritja ndihen që në momentin e parë. Ne krijojmë një ambient miqësor dhe mbështetës, ku çdo punonjës trajnohet me kujdes për t'u ndjerë rehat dhe i sigurt që në ditën e parë. Gjatë orarit të punës, kujdesemi për mirëqenien e ekipit tonë me ushqim të shijshëm dhe përfitime të brendshme që e bëjnë përvojën në PasaDoner edhe më të këndshme.

Detyrat dhe Përgjegjësitë Kryesore:

Parapërgatitja e përbërësve ushqimorë:

- Pastrim dhe prerje e perimeve dhe produkteve të tjera.
- Organizimi dhe vendosja e përbërësve në mënyrë higjienike dhe të strukturuar.
- Kontrolli i afateve të përdorimit dhe freskisë së produkteve.
- Përgatitja e sallatave ditore sipas standardeve të PasaDoner.
- Përgatitja dhe ruajtja e sosave tradicionale sipas recetave të përcaktuara.

Mirëmbajtja e pastërtisë dhe higjienës:

- Pastrim i përditshëm i tavolinave të punës, veglave të kuzhinës dhe pajisjeve.
- Kujdes për hedhjen e mbeturinave dhe ndjekja e praktikave të menaxhimit të mbetjeve.
- Zbatimi rigoroz i rregullave të higjienës personale dhe të ambientit të punës.

Çfarë Kërkojmë:

- Përvojë në ndihmë në kuzhinë (preferohet, jo e domosdoshme)
- Aftësi për të punuar në grup
- Vëmendje ndaj detajeve dhe pastërtisë
- Disponueshmëri për të punuar me turne dhe në fundjavë, sipas nevojës

Apliko sot!

Sill CV-në tënde në dyqan ose na shkruaj në:
info@pasadonerks.com, Facebook/Instagram

Pasa Doner – Traditë me Shije. Shërbim me Zemër.